



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1035/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 06 / 2019

V E N D I M

Nr. 80, Datë 27 / 06 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 23, datë 19.03.2019¹, të bërë nga A.N kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor (Rajoni Verior) Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike²”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumenteve të dërguara me e-mail-et³ datë 25, 26 dhe 27 Mars 2019, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Që prej vitit 2008 ka qenë i punësuar në pozicione të ndryshme në Administratën Tatimore. Në datë 07.11.2015 është larguar nga puna pa asnjë shkak të arsyeshëm, për të cilin është shprehur dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin nr.260 (298), datë 21.4.2017. Në datë 16.06.2017 është emëruar inspektor zbatimi, deri në datë 21.11.2018 kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për këtë ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me Vendimin nr. 153 (728) datë 14.02.2019 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke i dhënë dëmshpërblimet përkatëse sipas ligjit për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të*

¹ Ankesa është dorëzuar në datë 19.03.2019 dhe është plotësuar me shpjegime dhe dokumentacion në datë 27.03.2019.

² Referuar shkresës nr. 4, datë 14.03.2019 të lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Tropojë, A.N është anëtar i PD-s, Njësi Administrative Tropojë Fshat.

³ Në përgjigje të shpjegimeve të kërkuara nga inspektori i çështjes me e-mail-in datë 20.03.2019.

justifikuara. Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjësit e tjerë të sektorit të cilët nuk u larguan nga puna⁴. Ankuesi pretendon se largimi nga puna është bërë për shkak të bindjeve politike, pasi eprorët dhe kolegët shpesh e kanë konsideruar si përkrahës të Partisë Demokratike, për shkak se është me origjinë nga Tropoja”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së⁵, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 23, datë 19.03.2019 të A.N u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për

⁴ Me e-mail-in datë 27.03.2019 ankuesi ka dërguar listën e inspektorëve për të cilët ishte rekomanduar dhënia e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim nga puna” nga ana e grupit të kontrollit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

⁵ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 419/1, datë 01.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Hetimit Tatimor (Rajoni Verior) Shkodër për ankesën e bërë nga A.N si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituarat:
 - Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga detyra të punonjësit A.N.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2017 dhe 2018 për të gjithë punonjësit në detyrën, Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor (Rajoni Verior) Shkodër.
 - Kopje raportit sipas shkresës nr.11062/3, datë 31.10.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”.
 - Kopje të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të Hetimit Tatimor” të miratuar me Urdhrin nr.65, datë 04.10.2017.

Me shkresën nr. 6838/2, datë 18.04.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në mes të tjerash informoi se: *“A.N ka qenë Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor (Rajoni Verior) Shkodër. Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion (Ministria e Drejtësisë) ka dërguar në DPT shkresën nr.11062/3, datë 31.10.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”. Bazuar në këtë shkresë ka filluar procedimi disiplinor ndaj A.N. Me shkresën nr.22286/23, datë 07.11.2018, është njoftuar A.N për fillimin e procedimit disiplinor për zgjidhje të menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës. Në datë 12.11.2018 është zhvilluar takimi në Komisionin Disiplinor, në të cilën A.N iu relatuan shkeljet e pretenduara si dhe u dëgjuan pretendimet e ankuesit lidhur me shkeljet. Me Vendimin nr.617, datë 20.11.2018 ndaj A.N është marrë masa “Zgjidhje e menjëhershme e justifikuar e kontratës së punës””.*

- Me shkresën nr. 948, datë 12.06.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga DPT informacion mbi masat disiplinore të marra për 14 inspektorët e DHT Shkodër, në zbatim të rekomandimit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion nr. 11062/3, datë 31.10.2018.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 115, datë 20.06.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë DPT më datë 24.06.2019, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me I.K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Trajnimit dhe Vlerësimit, pranë DPT.

Gjatë inspektimit I.K informoi se, në përgjigje të shkresës nr. 948, datë 12.06.2019 të Komisionerit, DPT ka dërguar shkresën, “Kthim Përgjigje” nr.1180/1, datë 19.06.2019, në të cilën informohet se ndaj 14 punonjësve të DHT Shkodër ka filluar procedimi disiplinor sipas rekomandimeve të Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion dhe në përfundim të procesit disiplinor ndaj tyre është marrë masa “Zgjidhje e menjëhershme e justifikuar e kontratës së punës”. Nga ana e DPT u vendos në dispozicion të grupit të inspektimit, kopje të vendimeve për zgjidhje të menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës dhe ndërprerje të marrëdhënieve financiare për punonjësit: Gj.Gj, K.D, R.B, E.V dhe E.S.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

A.N me Vendimin nr. 507, datë 11.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT është emëruar në detyrën si Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër. Me shkresën nr. 22286/23, datë 07.11.2018, është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor për zgjidhje të menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës, në zbatim të rekomandimeve të përgatitura nga Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion, në të cilin është rekomanduar për dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna” për mospërbushje të rëndë të detyrave dhe moszbatim haptazi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale. Ankuesi me shkresën nr. 22286/53, datë 09.11.2018 ka dërguar observacionin e tij lidhur me njoftimin për fillimin e procedimit disiplinor në të cilën ka kundërshtuar rekomandimin e lënë nga Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion duke argumentuar se rekomandimi për largim nga puna nuk ishte proporcional dhe nuk përbënte faj të rëndë të përkthyer në dëm ekonomik ndaj punëdhënësit. Me Vendimin nr. 617, datë 20.11.2018 “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës dhe ndërprerje të marrëdhënieve financiare” të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj A.N është marrë masa “Zgjidhje e menjëhershme e justifikuar e kontratës së punës” për mospërbushje e rëndë të detyrave dhe moszbatim haptazi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.

Ankuesi duke mos rënë dakord me vendimin për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me Vendimin nr. 153 (728) datë 14.02.2019 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke i dhënë dëmshpërblimet përkatëse sipas ligjit për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuar, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se në përfundim të kontrollit të ushtruar në Drejtorinë e Hetimit Tatimor – Rajoni Verior, Shkodër⁶, Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion me shkresën nr. 11062/3, datë 31.10.2018 ka dërguar për zbatim pranë DPT, raportin e kontrollit të ushtruar në DHT, Shkodër. Në këtë raport, grupi i kontrollit në mes të tjerash ka rekomanduar masa disiplinore për “Largim nga puna” për subjektin ankues dhe 13 inspektorë të tjerë të DHT, Shkodër dhe masë disiplinore “Vërejtje ne paralajmërim për largim nga puna” për 13 inspektorë të DHT, Shkodër. Referuar dokumenteve të administruara, rezulton se DPT ka marrë masën disiplinore për “Largim nga puna”, për të gjithë inspektorët e DHT Shkodër, sipas rekomandimit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Në pikën 4 të VKM nr. 241, datë 20.04.2018 “Për miratimin e planit të veprimit 2018-2020, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015-2020, e të pasaportës së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Koordinator për zbatimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2015-2020, dhe task-forcës ndërinstitucionale antikorrupsion”, përcaktohet se: *“Krijimin e Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, e cila kryesohet nga ministri i Drejtësisë, Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion, dhe ka në përbërje këta anëtarë: - Përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit; - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik; - Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoriatit Qendror; - Drejtorin e Departamentit të Burimeve, Transparencës dhe Administrimit, në Kryeministri”*, ndërsa në pikën 6 të kësaj VKM-je përcaktohet se: *“Në përfundim të çdo inspektimi apo kontrolli, nga grupet e posaçme të inspektimit hartohet raporti që do t’i paraqitet Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Task-Forca e dërgon raportin pranë titullarëve të institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura”*.

Nga përmbajtja e aktit të sipërpërmendur rezulton se lufta kundër korrupsionit është një proces madhor i organizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë për të rritur efikasitetin e luftës kundër korrupsionit dhe për të përmirësuar shërbimin ndaj qytetarëve.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, Komisioneri vlerëson se grupi i kontrollit i ngritur për të ushtruar kontroll në DHT, Shkodër dhe i përbërë nga anëtarë të institucioneve të ndryshme të administratës shtetërore, nuk ka patur mundësi që të kishte dijeni për bindjet politike të subjektit ankues, për më tepër që ky grup kontrolli ka rekomanduar masë disiplinore për largim nga puna për 14 inspektorë të DHT, Shkodër dhe rekomandimi për largim nga puna nuk ka qenë vetëm për A.N.

Referuar pretendimeve të subjektit ankues kundër DPT, Komisioneri vlerëson se largimi i A.N nga puna nuk ka ardhur për shkak të perceptimit të bindjes së tij politike, por Drejtoria e

⁶ Në zbatim të Urdhrit nr. 9717, datë 25.09.2018 të Kryetarit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, znj. Etilda Gjonaj, Ministër i Drejtësisë.

Përgjithshme e Tatimeve ka zbatuar rekomandimin e Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion për zbatimin e masave administrative për kundërvajtjet administrative tatimore të konstatuara për rastet e shkeljeve të parashikuara në legjislacionin e procedurave tatimore.

Referuar raportit të grupit të kontrollit vërehet që ky grup ka rekomanduar dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna” për të gjithë pjesëmarrësit e urdhrave të shërbimit me të cilët ankuesi ka qenë për kontroll, si: Gj.Gj, K.D, R.B, E.V dhe E.S.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve krahasuar me punonjësit e tjerë të sektorit, pasi rekomandimi për dhënien e masës disiplinore nuk është bërë nga DPT por nga grupi i kontrollit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka

ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit A.N nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve për shkak të “bindjes politike”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

ROBERT GAJDA

KOMISIONER